



**INSTITUTI I KURRIKULËS DHE I TRAJNIMIT**

**PROGRAMET E KURRIKULËS ME ZGJEDHJE TË GJIMNAZIT**

**FUSHA : GJUHË SHQIPE – LETËRSI**

**LËNDA : LETËRSI**

**KODI : 4.01**

**PROGRAMI I LËNDËS LETËRSI PËR KLASËN E 10**

**TIRANË , DHJETOR 2008**

Studimi i letërsisë, në një kuptim më të ngushtë konkret dhe specifik, ka vlera thelbësore për formimin dhe zhvillimin e aftësive njohëse dhe krijuese të nxënësve pasi kjo lëndë:

- I ballafaqon ata me përvoja, rrethana, personazhe, vende, kohë dhe ngjarje që mund të jenë krejt të ndryshme nga përvoja e tyre e përditshme.
- “ I fton” ata të reflektojnë për domethënien e vlerave kulturore dhe aspektet kryesore të shoqërisë njerëzore; për të menduar dhe diskutuar tematika që janë thelbësore dhe universale.
- U jep atyre mundësinë për të kuptuar më mirë vetveten, për të kuptuar raportin e tyre me shoqërinë dhe botën që i rrethon, teksa imagjinojnë rrethanat, ndodhitë, karakteret e personazheve të veprave letrare etj.
- I ndihmon ata të kuptojnë gjithnjë e më mirë, duke studiuar veprat letrare, sesi krijuesit letrarë përdorin gjuhën për të krijuar nga njëra anë efekte emocionale estetike tek lexuesit si meditimi, heroikja, e madhërishmja, patosi, humori, ankthi, dhe, nga ana tjetër, mundësojnë deshifrimin e përmbajtjes në disa nivele kuptimore.
- U jep atyre mundësinë të studiojnë veprat dhe krijuesit më në zë në fushën e letërsisë.
- Krijon mjedisin e domosdoshëm për t’u mësuar nxënësve artin e komunikimit në klasë.

Programi i lëndës së letërsisë si lëndë me zgjedhje është i detyrueshëm për nxënësit që e zgjedhin atë.

**Ky program zbatohet nëpërmjet dy moduleve me të njëjtën tematikë “Bota dhe ndryshimi”.** Kjo tematikë shtjellohet përmes një veprë të letërsisë shqipe dhe një veprë të letërsisë botërore. Nxënësve, përmes zgjedhjes së njërit ose të dy moduleve, u mundësohet formimi letrar që nga leximi, kuptimi, zbërthimi i përmbajtjes së veprës deri tek analiza e plotë e saj, parashtrimi i qëndrimit të pavarur vlerësues, individual ose në grup.

## 1. SYNIMI I LËNDËS

Lënda e letërsisë synon të aftësojë nxënësin për të analizuar, për të gjykuar dhe për të vlerësuar veprën letrare, idetë dhe mesazhet që ajo përcjell, si dhe të nxisë zhvillimin mendor dhe emocional të tij.

## 2. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME

Në përfundim të programit të letërsisë nxënës/i,-ja:

- të analizojë **veprën letrare** duke punuar në mënyrë të pavarur dhe në grupe të vogla;
- të **parashtojë idetë dhe qëndrimet e tij/saj** për autorin dhe veprën e studiuar dhe të reflektojë sipas sugjerimeve, ideve dhe vlerësimeve që japin të tjerët;
- të **diskutojë** dhe të **bëjë punë të pavarur rreth ideve, analizave dhe vlerësimeve** për veprën;

- të hulumtojnë informacione, vlerësime dhe qëndrime rreth autorit dhe veprës në tërësi;
- të përgatisë dhe të parashtrijë me gojë dhe me shkrim punimet e tyre përgjithëse për vlerësim në fund të çdo tematike ose moduli;
- të krijojë qëndrimin e tij/saj për mënyrën e përfaqësjes dhe të studimit të teksteve dhe veprave të ndryshme;
- të krijojë dhe të shprehë qëndrimin e tij/saj vetjak për letërsinë.

Lënda e letërsisë si lëndë me zgjedhje zhvillon më tej, në kontekstin e veprës letrare, objektivat e kurrikulës bërthamë.

Linjat e kurrikulës bërthamë	Objektiva të nxënies sipas linjave
<b>Të lexuarit</b>	Në përfundim të lëndës së letërsisë, nxënës/i,-ja:
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të përdorë shprehitë dhe strategjitë e përgjithshme të procesit të të lexuarit.</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të përdorë shprehitë dhe strategjitë e të lexuarit për të kuptuar dhe interpretuar veprën letrare.</li> <li>• të përdorë shprehitë dhe strategji të të lexuarit për të kuptuar dhe interpretuar një larmi tekstesh informuese.</li> </ul>
<b>Të shkruarit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të përdorë shprehitë dhe strategjitë e përgjithshme të procesit të të shkruarit.</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të përdorë aspektet stilistike dhe retorike të të shkruarit.</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të përdorë rregullat gramatikore në kompozimet e shkruara.</li> </ul>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të mbledhë dhe përdorë informacionin për qëllime kërkimore.</li> </ul>
<b>Të dëgjuarit, të folurit dhe të shikuarit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të përdorë strategji të të dëgjuarit dhe të folurit për qëllime të ndryshme.</li> <li>• të përdorë shprehitë dhe strategji të të shikuarit për të kuptuar dhe interpretuar mediet pamore.</li> </ul>
<b>Media</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të dallojë dhe parashtrijë karakteristikat dhe komponentët e medias.</li> <li>• të kuptojë dhe diskutojë veprën letrare në realizime të ndryshme artistike, si kinematografi etj.</li> </ul>

**Në këtë lëndë nxënësit rishikojnë nëpërmjet veprës:**

- strukturën e fjalisë;
- shkrimin përshkrues, bindës, ekspozues;
- llojet e fjalisë;
- drejtshkrimin dhe pikësimin;
- fjalën dhe nëntekstin;
- strukturën e paragrafit;
- aftësitë e kërkimit, e përzgjedhjes, e shfrytëzimit të burimeve .

## **Kritere të konceptimit të moduleve**

Lënda e letërsisë si lëndë me zgjedhje është konceptuar në dy module të ndërtuar në bazë **teme dhe burimi**.

Sistemi modular i ndërtuar në këtë mënyrë:

- pasqyron kujdesin për rritjen personale të nxënësit (si lexues dhe shkruar) përkundrejt veprës letrare si objekt i vlefshëm studimi, si qëllim në vetvete
- u jep nxënësve mundësinë të përfshihen dhe të përparojnë në mësimin e letërsisë dhe të gjuhës shqipe.
- u jep mundësi nxënësve për të folur, për të dëgjuar, për të lexuar dhe për të shkruar rreth problematikave dhe çështjeve të veçanta.

### **a. Moduli i bazuar në tematikë dhe çështje:**

- ndihmon nxënësit të mësojnë gjuhën duke folur, duke dëgjuar, duke shkruar, duke lexuar, duke paraqitur dhe duke parë problematika, bindje dhe hamendësime rreth jetës dhe botës si dhe rreth gjuhës dhe teksteve që i shprehin ato;
- mundëson një studim ndërlëndor;
- duke u përdorur si një kornizë referuese për diskutim dhe kërkim, synon që nxënësit ta përdorin gjuhën dhe rregullat e saj në mënyrë të qëllimtë dhe të efektshme, ndërkohë që përpunojnë informacionin, marrin vendime, zgjidhin problemin dhe mendojnë në mënyrë krijuese dhe kritike;
- integron proceset gjuhësore.

### **b. Modul i bazuar tek burimet:**

- nxit nxënësit dhe mësuesit të përdorin një larmi burimesh për nxënien dhe mësimdhënien e tyre. Mësuesit nxiten të përzgjedhin dhe përshtatin materiale, të përshtatin mësimin dhe mjedisin e tyre për të plotësuar aftësitë, nevojat dhe interesat e secilit prej nxënësve;
- pasurojnë vlerësimin e nxënësit dhe zgjerojnë përvojat e tyre letrare me materialet burimore.

Duke synuar aftësimin e nxënësit për të analizuar, gjykuar dhe mbajtur qëndrim ndaj veprës letrare, ideve dhe mesazheve që ajo përcjell, procesi mësimor do të mbështetet në përdorimin e një larmie aktiviteteve nxënëje, nga diskutimet në grup tek ushtrimi sistematik i nxënësit në punimet me shkrim dhe prezantimet gojore. Ky proces nxënëje do t'i ndihmojë nxënësit të formojnë aftësitë e të menduarit kritik, të përmirësojnë të kuptuarin përmes leximit dhe të japin reagimet e tyre të argumentuara për atë që lexojnë, shkruajnë, paraqesin dhe diskutojnë.

Nxënësit do të vlerësohen për aftësitë e tyre në të kuptuarin dhe analizën e veprës e të stilit të autorit nëpërmjet pjesëmarrjes në diskutime formale e informale, shfrytëzimit dhe hulumtimit të burimeve alternative, përgatitjes dhe prezantimit të punimeve të tyre, shtjellimit të tematikave të ndërthurura dhe integruese brenda lëndës, fushës si dhe me fushat e tjera kurrikulare.

### 3. OBJEKTIVAT SIPAS MODULEVE

#### MODULI 1 : BOTA DHE NDRYSHIMI

**Tema qendrore :** Studimi i heroit, forca e tij (“Skënderbeu”, Sabri Godo)

**Orë mësimore të sugjeruara:** 36 orë

**Struktura e modulit:** Moduli përbëhet nga katër njësi mësimore, secila trajton një tematikë të caktuar , e zbërthyer në nëntematika e çështje.

Në këtë modul nxënësit parashtrojnë, ballafaqojnë dhe rrisin aftësitë e tyre në:

- pasqyrimin nëpërmjet letërsisë i kontekstit historik, politik, ekonomik, kulturor e filozofik ;
- eksplorimin e të shkruarit përshkrues, parashtrues, argumentues ;
- përdorimin e termave letrare;
- pasurimin e fjalorit;
- përdorimin në komunikim të strukturave gramatikore të përzgjedhura ;
- rritjen e kompetencës për komunikim me shkrim dhe me gojë.

Në këtë modul nxënësit do të eksplorojnë veten dhe shoqërinë. Lind pyetja “Si ndikojnë ngjarjet në përcaktimin e eksperiencës së shoqërisë? Për një temë të rëndësishme si **Bota dhe ndryshimi** natyrshëm pyet: Cili është roli i prijësit në ngjarjet e shoqërisë? Çfarë cilësish e bëjnë atë një prijës të mirë?

**Vepra që do të lexohet, do të analizohet dhe do të diskutohet :**

Sabri Godo: “ *Skënderbeu* “ roman me lëndë nga historia politike e Shqipërisë në shekullin e 15 –të, nga lufta popullore për mbrojtjen e tokës e të lirisë.

**Temat kryesore mësimore**

- **Tema e qëndresës** – me lëndë nga historia shumëshekullore e kombit, mbushur me ngjarje të mëdha.
- **Prijësi** – Skënderbeu, si strateg , burrë shteti , politikan dhe diplomat.
- **Letërsia fillon të flasë aty ku hesht historia dhe vetë historia projektohet në formë letrare.**

**NJESIA MESIMORE 1. Orë të sugjeruara: 9 orë**

“Histori e Skënderbeut” e Barletit - si parateksti për veprën “Histori e Skënderbeut” e Naimit, Nolit dhe në një masë të ndjeshme për romanin “Skënderbeu “ të Sabri Godos.

Bloku tematik	Objektiva të përgjithshme të njësisë mësimore
1. Tema e qëndresës 2. Prijësi 3. Letërsia fillon të flasë aty ku hesht historia dhe vetë historia projektohet në formë letrare	Në fund të kësaj njësie mësimore nxënës/i,-ja: <ul style="list-style-type: none"> <li>• të bëjë lidhjen midis veprës, autorit dhe periudhës letrare;</li> <li>• të analizojë veprën në elementët e saj;</li> <li>• të dallojë veçoritë e gjinive letrare në trajtimin e tematikës;</li> <li>• të parashtojë qëndrimin e tij/saj ndaj veprës.</li> </ul>

## TEMATIKAT DHE ÇËSHTJET MËSIMORE TË SUGJERUARA

**1. Figura e Skënderbeut** në letërsinë gojore, Barleti, Frank Bardhi, Jeronim De Rada, Gavril Dara ( I riu), Zef Skiroi, Naim Frashëri, Andon Zako Cajupi, Ndre Mjeda, Filip Shiroka, Fan.S. Noli.

Njohuri paraprake të domosdoshme:

1. **Marin Barleti:** “Historia e Skënderbeut “ Humanizmi evropian; Koha kur u shkrua; Qëllimi përse u shkrua; gjinia letrare ; gjuha (latinisht); Përkthimi.
2. **Naimi Frashëri:** “Historia e Skënderbeut “Romantizmi shqiptar. Koha kur u shkrua; Qëllimi përse u shkrua : politik, social etj., **por më shumë letrar – përpyekja për të krijuar një epos kombëtar**; Gjinia letrare ( poemë epiko-lirike, lloji i vargut, rimës etj.); Histori e legjendarizuar.
3. **Fan.S. Noli:** Historia e Skënderbeut “Koha kur u shkrua; Qëllimi përse u shkrua; Gjinia letrare :histori e letrarizuar e legjendarizuar - prozë poetike.

**2. Figura dhe epoka e Skënderbeut** si mundësi për të shprehur jehona të ndryshme shpirtërore.

Autori / Vepra	ÇËSHTJE MËSIMORE
<b>Naim Frashëri:</b>  <b>“Histori e Skënderbeut”</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• leximi;</li> <li>• vërtetësimi i të kuptuarit;</li> <li>• lidhja midis veprës, autorit dhe periudhës letrare;</li> <li>• analiza e elementëve të trillimit;</li> <li>• stilistika letrare;</li> <li>• gjinia letrare: poema, lloji i vargut, rima, etj;</li> <li>• të shkruarit përshkrues.</li> </ul>
<b>F.S. Noli:</b>  <b>“Histori e Skënderbeut”</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Leximi;</li> <li>• vërtetësimi i të kuptuarit;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• lidhja midis veprës, autorit dhe periudhës letrare;</li> <li>• analiza e elementëve si vendndodhja, toni, gjendja shpirtërore, karakteret, pika kulmore, kompozicioni;</li> <li>• ndërtimi i frazës dhe theksi ;</li> <li>• fjala dhe konteksti;</li> <li>• sintaksa poetike – fjala dhe fraza;</li> <li>• esklamacioni – pyetja;</li> <li>• të shkruarin përshkrues</li> </ul>
--	--

### 3. Figura e Skënderbeut në kinematografi. Filmi “Skënderbeu”.

#### Burimet mësimore bazë:

- “Histori e Skënderbeut“ N. FRASHËRI.
- “Histori e Skënderbeut“ F.S. NOLI; Vepra.
- Filmi “ Skënderbeu“.

#### Burime ndihmëse:

- Figura e Skënderbeut: Këngët popullore arbëreshe.
- Figura e Skënderbeut: Legjendat , gojëdhënat, toponimet.
- Figura e Skënderbeut: Marin Barleti, Frang Bardhi, Jeronim De Rada, Gavril Dara ( I riu), Zef Skiroi, Andon Zako Cajupi, Ndre Mjeda, Filip Shiroka.
- Media e shkruar dhe elektronike.
- Interneti.

#### NJESIA MESIMORE 2. Orë të sugjeruara: 10 orë

Blloku tematik	Objektiva
Tema e qëndresës, me lëndë nga historia shumëshekullore e kombit.	<p>Në përfundim të njësisë mësimore nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të përshkruajë kontekstin historik, shoqëror, ekonomik të letrar;</li> <li>• të reflektojë rreth lidhjeve të veprës letrare me kontekstin historik, shoqëror, ekonomik;</li> <li>• të analizojë aspektet gjuhësore të veprës: retorika; ndërtimi i frazës dhe theksi;</li> <li>• të eksplorojë burimet e veprës letrare;</li> <li>• të parashtrojë qëndrimin e tij ndaj veprës.</li> </ul>

**Vepra:** Sabri Godo “Skënderbeu“

TEMATIKA	ÇËSHTJE MËSIMORE
<p>1. Një përpjekje për ta vështruar historinë materialisht , për ta parë rezistencën e Skënderbeut në faktorët e vet politikë, historikë, ekonomikë.</p> <p>2. Skënderbeu:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• burrë shteti,</li> <li>• politikan dhe diplomat,</li> <li>• figurë historiko-letrare.</li> </ul> <p>3. Tematika dhe problematika e romanit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• leximi;</li> <li>• vërtetësimi i të kuptuarit;</li> <li>• konteksti historik, shoqëror, ekonomik;</li> <li>• gjuhë: retorika, analiza e retorikës;</li> <li>• ndërtimi i frazës dhe theksi;</li> <li>• sintaksa poetike: fjala dhe fraza;</li> <li>• ligjërimi bindës në fjalën e Skënderbeut;</li> <li>• gjuhë: fjalitë e plota;</li> <li>• struktura e paragrafit;</li> <li>• eksplorimi i një teme kritike: <ul style="list-style-type: none"> <li>a. diskutimi i forcës së retorikës;</li> <li>b. forca e retorikës ( shkrimi ekspozues).</li> </ul> </li> </ul>

**Burimet mësimore bazë:** Sabri Godo : “Skënderbeu “

**Burime ndihmëse:**

- Bibliotekë: artikuj kritikë mbi romanin.
- Tekste gjuhësore të përzgjedhura nga mësuesi e nxënësi.
- Fjalorë terminologjik, fjalorë të termave letrare.
- Enciklopedi .
- Media e shkruar dhe elektronike.
- Interneti.

### **NJESIA MESIMORE 3. Orë të sugjeruara: 10 orë**

Letërsia fillon të flasë aty ku hesht historia dhe vetë historia projektohet në formë letrare.

#### **Objektiva mësimore**

Në përfundim të njësisë mësimore nxënës/i,-ja:

- të parashtrorë , argumentojë dhe evoluojë idetë e qëndrimet e tij rreth vlerave të veprës;
- të eksplorojë burime dhe do diskutojë rreth një çështje si p.sh tipizimi dhe arsyeja figurative;
- të eksplorojë shkrimin përshkrues.

Vepra: Sabri Godo “Skënderbeu“



TEMATIKA	ÇËSHTJE MËSIMORE
<p>1. Historia shkrihet organikisht me trillimin; ku personazhe kryesorë nuk janë vetëm persona realë historikë, por edhe figura të krijuara; kombinimi i drejtë i historisë me artin, me letërsinë.</p> <p>2. Romani “Skënderbeu“ është një roman epike, larmia e ngjarjeve, rrethanave, konflikteve, karaktereve etj. Ruajtja e tistit legjendar në figurën e Skënderbeut. Dramaciteti.</p> <p>3. Arti i të përshkruarit, gjuha, stili.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• kompozicioni, kronologjia e ngjarjeve, rrethanat, mjediset, konflikti, karakteret; prologu, epilogu;</li> <li>• zhanri – romani epike;</li> <li>• romani historik; konceptimet romantike deri realiste për romanin historik;</li> <li>• ndërtimi i frazës dhe theksi, fraza e shkurtër, dramaciteti;</li> <li>• gjuhë: llojet e fjalisë;</li> <li>• ligjërimi bindës, Veprimi dramatik dhe Shkrimi bindës;</li> <li>• pika kulmore;</li> <li>• forca epike e kompozimit, dialogu;</li> <li>• esklamacioni – pyetja;</li> <li>• gjuhë: citimi i informacionit, dokumentit;</li> <li>• stili, gjuha figurative;</li> <li>• eksplorimi i shkrimit përshkrues;</li> <li>• eksplorimi i një teme kritike <ul style="list-style-type: none"> <li>a) diskutimi: tipizimi dhe arsyeja figurative.</li> </ul> </li> </ul>

**Burimet mësimore bazë:** Sabri Godo : “Skënderbeu“

**Burime ndihmëse:**

- Artikuj kritikë për romanin.
- Tekste gjuhësore të përzgjedhura nga mësuesi e nxënësi .
- Fjalorë terminologjik, fjalorë të termave letrare.
- Enciklopedi .
- Media.
- Interneti.

**NJESIA MESIMORE 4 . Orë të sugjeruara: 7 orë**

Bloku tematik	Objektiva
Vlerësimi i letërsisë: Duke gjetur zërin tim	<p>Në përfundim të njësisë mësimore nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të mbledhë informacion dhe diskutojë rreth çështjeve që lidhen me raportin kulturë-individ-vepër;</li> <li>• të gjykojë rreth vlerave të veprës duke iu referuar kriterëve, citimeve dhe argumenteve;</li> <li>• të parashtojë të strukturuar analizën, qëndrimin e</li> </ul>

	vlerësimin prej tij të veprës; • të dokumentojë procesin e nxënies.
--	--

**Rubrika: Takim me shkrimtarin**

TEMATIKA	ÇËSHTJE MËSIMORE
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Si e përçojnë kulturën e popullit shkrimtarët?</li> <li>• Si ndikon kultura në formimin e individit?</li> <li>• Si më ndihmon të përcaktoj identitetin tim dhe vlerat e mia debati me autorët dhe me lexuesit e tyre?</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• trajtimi i gjuhës, kultura e të shkruarit; individualiteti në komunikim;</li> <li>• shkrimi përshkrues e bindës: analizë dhe praktikë;</li> <li>• rishikimi dhe redaktimi i punimit ;</li> <li>• progresi në të shkruar.</li> </ul>

**Portofoli im: dokumentimi i progresit përmes punimeve të përzgjedhura**

- Mbledhja e ideve për një vlerësim (me bllokun e shënimeve).
- Shkrimi krijues : këndvështrimi juaj mbi romanin; Kuvendi i Lezhës; gjyqi i Hamzait; vdekja e Skënderbeut etj.
- Shkrimi krijues : Shkruani, ju, një prolog të romanit, duke përdorur : një frazë të shkurtër, që mbart mendim, një gjuhë të bukur dhe të rrjedhshme.
- Kërkime / studime sociale: Diskutim: E shkuara dhe e tashmja.
- Çfarë mësuat ju në këtë kurs: reflektim.

**Burimet mësimore bazë**

Sabri Godo : “Skënderbeu “  
 Artikuj të ndryshëm që përputhen me objektin.

**Burime ndihmëse**

- Tekstet gjuhësore të përzgjedhura nga mësuesi e nxënësit;
- Fjalorë terminologjik, fjalor të termave letrare;
- Enciklopedi;
- Media e shkruar dhe elektronike;
- Interneti.

## MODULI 2 : BOTA DHE NDRYSHIMI

**Tema qendrore :** Studimi i heroit, forca e tij (Jul Cezari)

**Orë mësimore të sugjeruara:** 36 orë

**Struktura e modulit:** Moduli përbëhet nga katër njësi mësimore, secila trajton një tematikë të caktuar, e zbërthyer në nëntematika e çështje.

Në këtë modul nxënësit parashtrajnë, ballafaqojnë dhe rrisin aftësitë e tyre në:

- pasqyrimin nëpërmjet letërsisë i kontekstit historik, politik, ekonomik, kulturor e filozofik;
- njohjen e veçorive të gjuhës shekspiriane, të stilit shekspirian;
- kuptimin e elementëve të dramës, aluzioni përmes dramës dhe lojës;
- përdorimin e termave letrare;
- pasurimin e fjalorit, kuptimin e fjalës në kontekstin specifik të veprës;
- përdorimin në komunikim të frazeologjive të përzgjedhura;
- rritjen e aftësive të tyre komunikuese me shkrim dhe me gojë;
- eksplorimin dhe përdorimin e formave të larmishme të shkruarit parashtrues dhe argumentues.

Në këtë modul nxënësit do të eksplorojnë veten dhe shoqërinë:

- Si ndikojnë ngjarjet në përcaktimin e përvojës së shoqërisë?
- Cili është roli i prijësit në ngjarjet e shoqërisë?
- Çfarë cilësish e bëjnë atë një prijës të mirë ?

**Vepra që do të lexohet, do të analizohet dhe do të diskutohet:**

Uliam Shekspir: “Jul Cezari“ (tragjedia e idealit republikan), dramë historike, me subjekt luftën për pushtet, luftën kundër tiranisë në Romën e lashtë.

**Temat kryesore mësimore**

- Përse një lider publik çmohet nga një grupim dhe kundërshtohet nga një tjetër ?
- Çfarë është “opinion i publik“? Kë drejton ai ?
- Nga se përbëhet “reputacioni“ ? Pse ndryshon ? Kur është iluzor?

**NJESIA MESIMORE 1. Orë të sugjeruara: 8 orë**

Blloku tematik	Objektiva
1. Kultura romane dhe karakteri njerëzor te Jul Cezari. “ Kur je në Romë bëj ashtu siç bëjnë romanët “.	Në përfundim të njësive mësimore nxënës/i,-ja <ul style="list-style-type: none"><li>• të parashtrorë veçoritë e pjesës;</li><li>• të ilustrojë karakteristikat e dramës dhe stilin shekspirian të saj;</li></ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të veçojë gjuhën figurative të përdorur, elementët e trillimit, të poezisë, të dramës;</li> <li>• të diskutojë dhe debatojë rreth retorikës dhe konfliktit ;</li> <li>• të dallojë forcën e ligjërimit kundërshtues dhe bindës midis palëve;</li> <li>• të parashtojë idetë e qëndrimet e tij/saj nëpërmjet të shkruarit bindës.</li> </ul>
--	--

### Vepra : “Jul Cezari “ Akti parë

TEMATIKA	ÇËSHTJE MËSIMORE
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Si përputhen fuqia e politikës dhe harmonia sociale midis tyre dhe kur janë në konflikt ?</li> <li>• Kultura romane dhe karakteri njerëzor të Jul Cezari. “ Kur je në Romë bëj ashtu siç bëjnë romanët “.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Leximi i aktit;</li> <li>• Vërtetësimi i të kuptuarit;</li> <li>• Vendndodhja, toni, gjendja shpirtërore;</li> <li>• Elementët e trillimit, poezisë, dramës;</li> <li>• Kuptimi i paralelizmit;</li> <li>• Gjuhë: Drama botërore dhe gjuha figurative; Retorika dhe konflikti; Fjalët dhe frazat;</li> <li>• Të shkruarit bindës;</li> <li>• <b>Shkrimi bindës 1</b> : “ Ligjërimi kundërshtues dhe bindës – zgjedhja e palëve”.</li> </ul>

#### Burimet mësimore bazë:

- “Jul Cezari”, Akti I;
- Tekste gjuhësore të përzgjedhura nga mësuesi e nxënësi;
- Fjalor terminologjik, fjalor i termave letrare.

#### Burime ndihmëse:

- Enciklopedi
- Media
- Internet.

#### NJESIA MESIMORE 2. Orë të sugjeruara: 8 orë

Bloku tematik	Objektiva
1. A janë politika dhe	Në përfundim të njesisë mësimore nxënës/i,-ja

<p>historia pasqyrë e natyrës njerëzore ?</p> <p>2. Vlerësimi i njeriut . Tipizimi.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• të parashtrorjë veçoritë e pjesës;</li> <li>• të ilustrojë karakteristikat e personazheve: <ul style="list-style-type: none"> <li>- tipizimi dhe e veçanta</li> <li>- prototipi dhe konflikti;</li> </ul> </li> <li>• të veçojë gjuhën figurative të përdorur; elementët e trillimit, të poezisë, të dramës;</li> <li>• të diskutojë dhe debatojë rreth ligjërit bindës dhe veprimi dramatik;</li> <li>• të parashtrorjë idetë e qëndrimet e tij/saj nëpërmjet të shkruarit bindës, vlerësimit e përmirësimit të tij.</li> </ul>

### Vepra : “Jul Cezari “ Akti II

TEMATIKA	ÇËSHTJE MËSIMORE
<p>1. A janë politika dhe historia pasqyrë e natyrës njerëzore ?</p> <p>2. Vlerësimi i njeriut . Tipizimi.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• leximi i aktit;</li> <li>• vërtetësimi i të kuptuarit;</li> <li>• tërësia e cilësive, karakteri;</li> <li>• vlerësimi i njeriut. Tipizimi (prototipi dhe konflikti);</li> <li>• tipizimi dhe arsyeja figurative;</li> <li>• fjalori në kontekst;</li> <li>• fjalitë emërore;</li> <li>• struktura e fjalisë, përsëritja e fjalisë;</li> <li>• argumentimi në ligjërimin e Jul Cezarit;</li> <li>• ligjërimi bindës, veprimi dramatik dhe shkrimi bindës;</li> <li>• <b>shkrimi bindës</b>: formulimi dhe shprehja e opinionit;</li> <li>• rishikimi dhe redaktimi i shkrimit ;</li> </ul>

#### Burimet mësimore bazë:

- Jul Cezar, Akti II;
- Fjalor terminologjik, fjalor i termave letrare;
- Tekste gjuhësore të përzgjedhura nga mësuesi e nxënësi .

#### Burime ndihmëse:

- Enciklopedi.
- Media.

- Internet.

### NJESIA MESIMORE 3. Orë të sugjeruara: 8orë

Bloku tematik	Objektiva
Si përputhet “ opinionin publik” me konceptin romak të retorikës ? Nga konflikti i dhunshëm te konflikti retorik : Duke fituar opinionin publik.	Në përfundim të njesisë mësimore nxënës/i,-ja <ul style="list-style-type: none"> <li>• të parashtrorjë veçoritë e pjesës;</li> <li>• të ilustrojë karakteristikat e veçoritë e pjesës: <ul style="list-style-type: none"> <li>- retorika e analiza e saj;</li> <li>- pika kulmore.</li> </ul> </li> <li>• të veçojë gjuhën figurative të përdorur;</li> <li>• të diskutojë dhe debatojë rreth një teme që lidhet me pjesën;</li> <li>• të parashtrorjë idetë e qëndrimet e tij/saj nëpërmjet të shkruarit bindës, vlerësimit e përmirësimit të tij .</li> </ul>
•	

### Vepra: “Jul Cezari “ Akti III

TEMATIKA	ÇËSHTJE MËSIMORE
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Si përputhet “ opinionin publik” me konceptin romak të retorikës ?</li> <li>• Nga konflikti i dhunshëm te konflikti retorik : Duke fituar opinionin publik.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• leximi i aktit;</li> <li>• vërtetësimi i të kuptuarit;</li> <li>• retorika; Analiza e retorikës;</li> <li>• struktura e fjalisë;</li> <li>• pika kulmore;</li> <li>• fjalitë e plota ;</li> <li>• struktura e paragrafit;</li> <li>• eksplorimi i një teme kritike: diskutimi i forcës së retorikës; shkrimi ekspozues (forca e retorikës).</li> </ul>

#### Burimet mësimore bazë

- Jul Cezar, Aktet 1-3;
- Tekste gjuhësore të përzgjedhura nga mësuesi e nxënësi ;
- Fjalor terminologjik, fjalor të termave letrare.

#### Burime ndihmëse

- Enciklopedi.
- Media.
- Internet.

#### **NJESIA MESIMORE 4. Orë të sugjeruara: 12 Orë**

<b>Bloku tematik</b>	<b>Objektiva</b>
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Roli e vlerat e dramave të Shekspirit për idealet e mëdha të kulturës perëndimore – individualizimin, ndershmërinë, drejtësinë, të vërtetën.</li> <li>2. Shekspiri dhe vizioni i tij për botën , jetën njerëzore, shtetin, moralin.</li> <li>3. Forca e gjuhës shekspiriane në plazmimin e karaktereve të personazheve..</li> </ol>	<p>Në përfundim të njësisë mësimore nxënës/i,-ja</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• do të parashtrijë me gojë e me shkrim, individualisht dhe në grup, idetë e qëndrimet e tij rreth tematikave përgjithësuese</li> </ul>

#### **Çështje mësimore të sugjeruara**

Eksplorimi i temës kritike: Të shkruarit ekspozues;  
 Rishikimi i fjalive;  
 Leximi ose parafrazimi / inversioni dhe fjalitë mungesore;  
 Subjektet në pozicione të pazakonta;  
 Fjalja e përbërë dhe shenjat fundore;

#### **Akti IV**

- Leximi i aktit IV.
- Vërtetësimi i të kuptuarit.
- Gjuha figurative.
- Dialogu, monologu.
- Ngjyrim (konotation) / kuptimi i saktë (denotation ), kuptimi parësor dhe dytësor i fjalës.

#### **Akti V**

- Leximi i aktit V.
- Vërtetësimi i të kuptuarit.
- Tragjedia dhe heroi tragjik.
- Tema.
- Analogjia.
- Refleksioni individual pas leximit.

**Veprimtari praktike: Diskutim, reflektim, punë të pavarura**  
**Orë të sugjeruara: 2 orë**

Përsëritje e njësive të modulit.

Historia dhe idetë e mëdha përmes dramës historike “Jul Cezari”.

**Burimet mësimore bazë**

- Jul Cezari, Aktet 1-5.
- F.S.Noli, Vepra 5.
- Tekste gjuhësore të përzgjedhura nga mësuesi e nxënësi.
- Fjalor terminologjik, fjalor të termave letrare.

**Burime ndihmëse**

- Enciklopedi.
- Media.
- Internet.



#### 4. TABELA E KËRKESAVE TË GJUHËS SHQIPE NDAJ LËNDËVE TË TJERA

<b>Letërsia</b>	<b>Historia</b>
Të lexuarit Të shkruarit Të kuptuarit Të interpretuarit	Nxënës/i,-ja: - të përdorë ngjarjet historike për të kuptuar dhe për të interpretuar veprën letrare.
<b>Letërsia</b>	<b>Arti Pamor</b>
Të lexuarit Të shkruarit Të kuptuarit Të interpretuarit	Nxënës/i,-ja: - të interpretojë karakteristikat e veprave të artit pamor në periudha të ndryshme kohore dhe kontekste të ndryshme kulturore; - të përdorë elementet dhe parimet e artit pamor për të shprehur emocionet e marra nga një tekst.
<b>Letërsia</b>	<b>Teknologji</b>
Të lexuarit Të shkruarit Të kuptuarit Të interpretuarit	Nxënës/i,-ja: - të shkruajë në Word tekste të llojeve të ndryshme; - përdor programin Power Point për të bërë prezantime të ndryshme; - të përdorë internetin për të nxjerrë informacione të ndryshme nga letërsia; - të përdorë mjete të ndryshme elektronike, si: kompjuter, magnetofon, diktofon, video për qëllime të ndryshme.
<b>Letërsia</b>	<b>Filozofia</b>
Të lexuarit Të shkruarit Të kuptuarit Të interpretuarit	Nxënës/i,-ja: - të interpretojë vepra dhe rryma të ndryshme filozofike të periudhave të ndryshme kohore.
<b>Letërsia</b>	<b>Psikologjia</b>
Të lexuarit Të shkruarit Të kuptuarit Të interpretuarit	Nxënës/i,-ja: - të interpretojë lidhjen e elementeve psikologjike me karakteret e personazheve dhe të figurave të ndryshme të botës së letrave.

## **5. KËRKESA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT**

Ky program është një dokument zyrtar, pjesë e tërësisë së dokumenteve zyrtare për t'u zbatuar në lëndën e gjuhës shqipe dhe letërsisë. Dokumentet e tjera kryesore janë korniza kurrikulare e gjimnazit dhe standardet e fushës kurrikulare, ku bën pjesë edhe kjo lëndë. Hartimi i programit është mbështetur si te korniza kurrikulare ashtu edhe te standardet e fushës.

Për të siguruar përdorimin sa më të mirë të programit është e vlefshme njohja me dokumentet e lartpërmendura.

Te korniza kurrikulare vëmendje e veçantë u duhet kushtuar:

- Synimeve të përgjithshme të kurrikulës së gjimnazit.
- Synimeve të linjave ndërkurrikulare.
- Vlerësimin të nxënësit me notë.
- Parimeve të mësimdhënie/mësimnxënies.

Në mënyrë që tërësia e dokumenteve zyrtare (korniza kurrikulare, standardet e fushës së të nxënësve dhe programi lëndor) të zbatohen më së miri në dobi të nxënësve, përdoruesit e tyre duhet të njohin thellë programet lëndore të lëndës së gjuhës shqipe për klasën paraardhëse dhe klasat pasardhëse.

Gjithashtu, përdoruesve të këtyre dokumenteve u lind nevoja të njohin standardet e të gjitha fushave të tjera të të nxënësve dhe të gjitha programet lëndore të të njëjtit vit.

Zbatimi i programit duhet të bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore e fetare.

### **Kërkesa të veçanta të lëndës së letërsisë**

Mësimdhënia e letërsisë duhet të përmbajë jo vetëm transmetimin e njohurive për veprat letrare, por, ç'është më e rëndësishme, duhet të synojë zhvillimin e aftësive të nxënësit për të shijuar e vlerësuar në mënyrë kritike letërsinë.

Në mësimdhënien e letërsisë theksi duhet të vihet në krijimin e mundësive, që do t'i ndihmojë nxënësit të zhvillojnë aftësinë si për të reaguar me ndjeshmëri dhe kënaqësi ndaj teksteve, ashtu dhe për t'i analizuar ato në mënyrë kritike. Për të realizuar këtë, mësuesit duhet të përdorin si artin, ashtu edhe shkencën e mësimdhënies.

Përmbajtja e lëndës do të ketë karakter të theksuar zbatues, duke mënjeluar e minimizuar karakterin parashtrues dhe informues.

Në thelb, procesi mësimor ka pasjen nga të gjithë nxënësit, pavarësisht nga dallimet e tyre në interesa, të njohurive dhe të shprehive paraprake. Ndaj në qendër të zbatimit të programit është ballafaqimi i drejtpërdrejtë i nxënësit me veprën, aftësimi i tij për të evidentuar vlerat, për të mbajtur një qëndrim të tijin ndaj veprës, duke shmangur kështu parashtrimin e njëanshëm të saj nga mësuesi.

Në fillim të lëndës mësuesi duhet t'i njohë nxënësit me natyrën e zhvillimit të saj, me përmbajtjen e moduleve, me çështjet që do të trajtojnë. Temat e njësive mësimore të modulit janë **orientuese**; vetë nxënësit ose në bashkëpunim me mësuesin mund të propozojnë edhe ndonjë temë tjetër brenda modulit.

Moduli ka në qendër diskutimin, debatin. Ai mbështetet në punën e pavarur, kërkimore të burimeve që i duhen nxënësit për orën e mësimit. Për trajtimin e temave të modulit mësuesi të përdorë punën individuale dhe në grupe. Gjithashtu, brenda çdo njësie mësimore nxënësit zhvillojnë punë me shkrim në përputhje me objektivat kryesore.

Moduli mbështetet në njohuritë paraardhëse të nxënësit në lëndët: gjuhë shqipe, folklor, histori, gjeografi, shkenca sociale. Këto njohuri nxënësit do t'i pasurojnë dhe do t'i thellojnë nëpërmjet debatit dhe punës në grup.

Vepra letrare, e përzgjedhur për zbërthimin e idesë madhore, duhet të lexohet nga nxënësit. Nxënësit, për zhvillimin e njësisë mësimore, duhet të kenë veprën letrare si mjet pune.

Në qendër **do të jetë puna e pavarur dhe në grupe të vogla e nxënësit**, për të kuptuar konceptet e strategjitë bazë, që mundësojnë analizën e **pavarur** të veprës letrare.

Procesi i nxënies do të mbështetet shumë në **hulumtimin** e informacionit dhe në lirinë e përzgjedhjes e të shprehjes se mendimeve të nxënësit për autorin dhe veprën letrare.

Vlerësimi i nxënësit do të bazohet në kritere të qarta e të shpallura për të gjykuar objektivisht për vlerat formuese që përfaqësojnë punimet me shkrim dhe prezantimet me gojë të nxënësit .

Lënda do të ofrojë mundësi sistematike e të larmishme që nxënësi të demonstrojë gjatë procesit të nxënies dhe në përfundim të tij formimin letrar të synuar, të lidhur ngushtë me objektivat e modulit.

## **Roli i mësuesit**

Mësuesi është lehtësues i punës së pavarur të nxënësve në fitimin e njohurive. Ai luan një rol kyç për të lehtësuar studimin e letërsisë dhe për të zhvilluar aftësitë e nxënësit për nxënie të pavarur. Për të realizuar misionin e tij mësuesi duhet të inkurajohet që :

- të sqarojë me nxënësit synimet e nxënies dhe përmbajtjen;
- të ruajë dhe të krijojë një atmosferë pozitive dhe harmonike për nxënien;
- të mbështesë pjesëmarrjen aktive të nxënësve;
- të veprojë si një model i një nxënësi të letërsisë;
- të përshtatë mësimdhënien me interesat dhe reagimet e nxënësit;
- të nxisë cilësinë e bashkëveprimit në klasë;
- të japë orientimet e duhura dhe *feedback* cilësor;
- të nxisë nxënien e pavarur.

Mësuesi duhet të përgatisë (ose përzgjedhë) instrumente didaktikë për aftësimin e nxënësit në analizën e pavarur të veprës.

### **Rolet e nxënësve**

Kritika letrare ka të bëjë më shumë me aftësi që duhen zhvilluar, sesa me një grup njohurish që duhen marrë. Mësuesi është për të demonstruar këtë aftësi dhe për të dhënë mbështetje dhe *feedback*, ndërkohë që nxënësit kanë nevojë që të shikojnë dhe të lexojnë vetë vepra dhe të sigurohen që po aftësohen si t’i diskutojnë për to në mënyrë kritike. Ata duhet të ushtrojnë imagjinatën e tyre, të reagojnë me emocion dhe të krijojnë tekstet e tyre. Për të shpjeguar qartë opinionet dhe idetë e tyre, në një punë grupi, nxënësit duhet të zhvillojnë një fjalor kritik. Ndërkohë që bëjnë kritikën e teksteve, nxënësit kanë nevojë t’u besohet, të reflektojnë dhe të jenë të gatshëm të ndajnë me të tjerët punimet e tyre me shkrim si dhe punimet e të tjerëve.

Nxënësit, gjatë dhe në përfundim të çdo teme të programit, duhet të bëjë përzgjedhjen e punimeve për të ndërtuar dosjen e punimeve të tij më të arrira.

## **6. VLERËSIMI**

Vlerësimi i nxënësit përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi.

Vlerësimi i nxënësit nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat e programit lëndor dhe mësues/i,-ja nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ato objektiva të arritjes që nuk përshkruhen në program.

Mësues/i,-ja zhvillon vetë dhe ndihmon nxënësit të zhvillojnë një larmi mënyrash vlerësimi.

### **Procesi i vlerësimit në letërsi**

Vlerësimi dhe mësimdhënia janë të shkrira midis tyre brenda kurrikulës idealisht, në një mënyrë të pazgjidhshme. Por, për ta përdorur vlerësimin brenda mësimdhënies në mënyrë efektive kërkohet mbi të gjitha, të njihet fakti se instrumente të ndryshme të tij duhet të përdoren për qëllime të ndryshme. Vlerësimet e mëposhtme janë vendimtare për arritjen e standardeve të vendosura në lëndën e letërsisë:

#### **Vlerësimi hyrës:**

- A zotërojnë nxënësit njohuritë dhe aftësitë e duhura për klasën e 10?
- A zotërojnë ata një pjesë të materialit që do t’u mësohet?

Rezultatet e këtij vlerësimi e ndihmojnë mësuesin për planifikimin e modulit, si dhe për ndërmarrjen e modifikimeve të mundshme për nxënës të caktuar apo grup nxënësish.

#### **Monitorimi i progresit:**

- A po përparojnë nxënësit në mënyrë të përshtatshme drejt arritjes së standardeve?
- A ka nevojë për përmirësim të mësimdhënies?
- A vendoset theksi i nevojshëm në komponentët e duhur të mësimdhënies, të cilët do të përdoren edhe në mësimet pasardhëse?

Ky vlerësim duhet të zhvillohet në intervale të shpeshta dhe të dhënat e marra prej tij duhet të përdoren menjëherë për t'iu përgjigjur nevojave të nxënësve si dhe përshtatjes së mësimdhënies. Çdo test i zhvilluar në klasë duhet të ketë të përcaktuar mirë sistemin e pikëve, nivelin kalues, mesatar dhe të lartë. Në përpjekje për të siguruar progresin e çdo nxënësi, të dhënat e marra nga vlerësimi duhen analizuar në nivel nxënësi dhe klase. Meqenëse procesi i monitorimit të progresit është një veprimtari bashkëpunuese dhe profesionale, të dhënat e marra prej tij duhen diskutuar me mësuesit e tjerë të lëndës për të analizuar dhe për të identifikuar nevojat e nxënësve, për të vendosur se cilat strategji janë më efektive.

Vëzhgimet në klasë, minitestet, vlerësimet e standardizuara janë disa nga instrumentet që mësuesit përdorin për të matur progresin e nxënësve kundrejt standardeve të vendosura.

Është absolutisht e pamundur të anashkalohej përdorimi i të dhënave nga rezultatet e arritura, si bazë për marrjen e vendimeve për përmirësimin e procesit të mësimdhënies.

Mësuesit kanë nevojë t'iu përgjigjen vazhdimisht pyetjeve të tilla si:

A duhet të eci më përpara?

A duhet të shpenzojë më shumë kohë në këtë fazë të mësimdhënies?

A janë në gjendje nxënësit të zbatojnë në mënyrë të pavarur çfarë kanë mësuar?

A duhet të japë udhëzime specifike shtesë?

Nëse nxënësit nuk po arrijnë atje ku synojmë, çfarë duhet të ndryshojë për të arritur standardet?

#### ***Vlerësimi përmbledhës:***

- A janë arritur qëllimet e vendosura nga standardet?

Nxënësit vlerësohen për përdorimin e aftësive në situata të njohura dhe të panjohura dhe ata duhet t'iu analizojnë dhe vlerësojnë ato, duke shfrytëzuar të gjitha njohuritë dhe aftësitë e fituara përgjatë kursit të letërsisë. Nëse nxënësi i zotëron aftësitë e tij në mënyrë të mjaftueshme ai/ajo duhet t'iu zbatojnë ato përtej materialeve të përdorura gjatë mësimdhënies.

Vlerësimi përmbledhës, nuk është thjesht një reflektim i njohurive të fituara por, bashkë me standardet dhe kurrikulën, janë një tregues i vlefshëm dhe i besueshëm i thellësisë së të kuptuarit dhe mënyrës se si ai transmetohet dhe përgjithësohet.

Megjithëse ka dhe shumë qëllime të tjera të vlerësimit, këto te tria, të listuara më sipër, janë vendimtare për këtë kornizë, pasi ato informojnë mësimdhënien. Të marra së bashku, ato formojnë një hartë për arritjen e standardeve që përfshijnë: pikën e nisjes,

itinerarin që duhet ndjekur, pikat në të cilat ky itinerar mund të ndryshohet dhe pikëmbërritjen.